

UDHËZIM
Nr. 15, datë 8.7.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË FINANCAVE NR. 11,
DATË 23.7.2024, “PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE PËR SHMANGIEN E
TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 10, pika 1, dhe 115/3, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 11, datë 23.7.2024, “Për zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”, të ndryshuar, në pikën 6.1., togfjalëshi “...brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2025...” zëvendësohet me togfjalëshin “...nga data 1 janar 2026...”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj